



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Punëve të Brendshme
Ministarstvo Unutrašnjih Poslova-Ministry of Internal Affairs



AKADEMIA E KOSOVËS PËR SIGURI PUBLIKE
KOSOVSKA AKADEMIJA ZA JAVNU BEZBEDNOST
KOSOVO ACADEMY FOR PUBLIC SAFETY

Plani Strategjik për Hulumtimet Shkencore në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike 2026-2028

Vushtrri, 2025

PËRMBAJTJA:

Lista e shkurtesave	4
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	5
I. HYRJE.....	7
I.1. Konteksti institucional	7
I.2. Lidhja me politikat kombëtare të arsimit të lartë, hulumtimit shkencor dhe sigurisë	8
II. MISIONI, VIZIONI DHE VLERAT	10
II.1. Misioni.....	10
II.2. Vizioni	10
II.3. Vlerat	10
III. ANALIZA E GJENDJES AKTUALE.....	11
III.1. Gjendja aktuale.....	11
III.2. Struktura, burimet njerëzore dhe infrastruktura	11
III.2.1. Struktura	11
III.3.1. Burimet njerëzore	12
III.3.2. Infrastruktura	13
IV. FUSHAT KRYESORE TË HULUMTIMIT NË SIGURINË PUBLIKE	14
IV.1. Fusha 1 - Politikat dhe qeverisja e sigurisë publike.....	14
IV.2. Fusha 2 - Rendi publik dhe siguria kufitare	14
IV.3. Fusha 3 - Menaxhimi i krizave dhe emergjencave	14
IV.4. Fusha 4 - Kriminaliteti dhe strategjitë e parandalimit.....	15
IV.5. Fusha 5 - Krimet kibernetike dhe siguria digjitale.....	15
IV.6. Fusha 6 - Radikalizmi, ekstremizmi i dhunshëm dhe terrorizmi	15
IV.7. Fusha 7 - Korrektimi dhe sprovimi	16
V. NDËRLIDHJA E FUSHAVE HULUMTUESE ME STANDARDET DHE NORMAT NDËRKOMBËTARE.....	17
V.1. Fusha 1 - Politikat dhe qeverisja e sigurisë publike	17
V.2. Fusha 2 - Rendi publik dhe siguria kufitare	18
V.3. Fusha 3 - Menaxhimi i krizave dhe emergjencave.....	18
V.4. Fusha 4 - Kriminaliteti dhe strategjitë e parandalimit.....	19

V.5. Fusha 5 - Krimet kibernetike dhe siguria digjitale	19
V.6. Fusha 6 - Radikalizmi, ekstremizmi i dhunshëm dhe terrorizmi	20
V.7. Fusha 7 - Korrektimi dhe sprovimi	21
VI. OBJEKTIVAT STRATEGJIKË.....	22
VI.1. OBJEKTIVI 1: Rritja e produktivitetit shkencor në fushën e sigurisë publike	23
VI.3. OBJEKTIVI 3: Zhvillimi i platformave shkencore për prezantim dhe publikim në fushën e sigurisë publike dhe forcimi i kapaciteteve institucionale për menaxhimin e hulumtimeve .	25
VII. ZBATIMI, MONITORIMI DHE VLERËSIMI	26
VIII. PLANI I VEPRIMIT I PLANIT STRATEGJIK TË HULUMTIMEVE SHKENCORE NË AKADEMINË E KOSOVËS PËR SIGURI PUBLIKE 2026-2028.....	27

Lista e shkurtesave

AKSP	Akademia e Kosovës për Siguri Publike
FSP	Fakulteti i Sigurisë Publike
KF	Këshilli i Fakultetit të Sigurisë Publike
IHZH	Instituti për Hulumtim dhe Zhvillim
DBF	Divizioni për Buxhet dhe Financave
DMJ	Divizioni për Marrëdhënie me Jashtë
DP	Drejtori i Përgjithshëm i AKSP
Dekani	Dekani i Fakultetit të Sigurisë Publike
MASHTI	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
DPSÇL	Departamenti për Planifikim Strategjik dhe Çështje Ligjore
WoS	Web of Science (platformë ndërkombëtare për indeksimin e publikimeve shkencore)
SCOPUS	Platformë ndërkombëtare për indeksimin e publikimeve shkencore

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Plani Strategjik për Hulumtimet Shkencore në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike 2026–2028 është dokumenti bazë, i cili përcakton drejtimet dhe prioritetet në fushën e hulumtimit shkencor, duke e vendosur komponentën hulumtues në qendër të misionit institucional të Akademisë. Ky plan është hartuar si produkt i Strategjisë Zhvillimore të AKSP-së 2023–2026, si dhe lidhet ngushtë me politikat kombëtare të arsimit të lartë dhe hulumtimit shkencor, përfshirë Strategjinë e Arsimit 2022–2026 dhe Strategjinë e Sigurisë e Kosovës 2022–2027.

Misioni i planit është ofrimi i hulumtimeve shkencore cilësore në fushën e sigurisë publike, të orientuara drejt ndikimit praktik dhe ndërkombëtarizimit, në funksion të politikë-bërjes, zhvillimit akademik dhe rritjes së sigurisë publike në Republikën e Kosovës. Vizioni është që Akademia të bëhet institucion kredibil dhe me ndikim në fushën e hulumtimeve të sigurisë publike, duke ndërtuar një kulturë të qëndrueshme hulumtimit, të njohur për cilësi, ndikim praktik dhe integritet ndërkombëtar. Plani bazohet në pesë vlera udhëheqëse: ekselencia shkencore, integriteti akademik, bashkëpunimi institucional dhe ndërkombëtar, inovacioni dhe aplikueshmëria, si dhe qëndrueshmëria institucionale.

Dokumenti pasqyron gjendjen aktuale të kapaciteteve hulumtimit të Akademisë, përfshirë publikimet shkencore të indeksuara në Scopus dhe Web of Science, projektet në bashkëpunim me MASHTI dhe përfshirjen e studentëve dhe hulumtuesve të rinj. Infrastruktura e Akademisë, që përfshin laboratorët simuluese, qytetin imagjinar dhe Institutin për Hulumtim dhe Zhvillim, paraqet një bazë solide për zhvillimin e mëtejshëm.

Plani përcakton shtatë fushta prioritare të hulumtimit: politikat dhe qeverisja e sigurisë publike; rendi publik dhe siguria kufitare; menaxhimi i krizave dhe emergjencave; kriminaliteti dhe strategjitë e parandalimit; krimet kibernetike dhe siguria digjitale; radikalizmi, ekstremizmi i dhunshëm dhe terrorizmi; si dhe korrektimi dhe sprovimi. Secila prej këtyre fushave lidhet drejtpërdrejt me standardet dhe normat ndërkombëtare, duke garantuar krahasueshmëri dhe zbatueshmëri.

Plani Strategjik për Hulumtimet 2026–2028 përcakton tre objektiva strategjike:

Objektivi 1: Rritja e produktivitetit shkencor në fushën e sigurisë publike

Objektivi 2: Rritja e numrit të projekteve hulumtuese në fushën e sigurisë publike

Objektivi 3: Zhvillimi i platformave shkencore për prezantim dhe publikim në fushën e

sigurisë publike dhe forcimi i kapaciteteve institucionale për menaxhimin e hulumtimeve. Zbatimi i planit do të bëhet nga IHZH dhe stafi akademik, secila brenda detyrave dhe përgjegjësi konkrete, në bashkëpunim me Dekanin dhe njësitë e tjera të Akademisë, përmes një plani veprimi me aktivitete të matshme, burime financiare të përcaktuara dhe mekanizma raportimi periodik. Monitorimi dhe vlerësimi do të sigurojnë transparencë, përgjegjësinë institucionale dhe përshtatshmërinë me zhvillimet e reja akademike, shkencore dhe shoqërore. Ky plan është bazë e rëndësishme drejt krijimit të një kulture hulumtuese të qëndrueshme institucionale dhe me ndikim, duke e pozicionuar Akademinë si referencë shkencore kombëtare dhe partnere e besueshme në rrjetet ndërkombëtare të sigurisë publike.

I. HYRJE

I.1. Konteksti institucional

Akademia e Kosovës për Siguri Publike është institucion unik në fushën e sigurisë publike në Republikën e Kosovës, i cili sipas Ligjit nr. 04/L-053 për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike ka fushëveprim për të ofruar trajnim, arsim të lartë dhe për të zhvilluar kapacitete në fushën e sigurisë publike. Strategjia Zhvillimore dhe Plani i Veprimit i AKSP 2023-2026 ka përcaktuar gjashtë objektiva strategjike, ndër të cilët njëra shtyllë e veçantë është zhvillimi i profilit hulumtues në interes dhe shërbim të sigurisë publike. Ky orientim strategjik institucional e ka vendosur hulumtimin shkencor në qendër të misionit të Akademisë, si dhe vizionit të saj, krahas fushës së trajnimit dhe fushës së arsimit të lartë në siguri publike. Në kuadër të kësaj shtylle, AKSP ka synuar ngritjen e kapaciteteve hulumtuese, zhvillimin e projekteve shkencore dhe publikimin e rezultateve që janë me interes shkencor dhe akademik dhe që ndihmojnë institucionet e sigurisë publike në përballje me sfidat bashkëkohore të sigurisë, e veçanërisht të sigurisë publike. Meqë hulumtimet janë fushë tejet e rëndësishme edhe e fushëveprimit të Akademisë, por edhe interes i rëndësishëm i institucioneve të sigurisë publike, është menduar që të hartohet një dokument strategjik i veçantë që duhet të reflektojë elementet e misionit institucional dhe ligjor, nevojat që kanë institucionet e sigurisë publike për produkte dhe aktivitete shkencore në interes të përmirësimit të politikave dhe zbatimit të ligjit. Andaj, Plani strategjik për hulumtimet shkencore në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike 2026-2028 ndërtohet mbi këto premisa, duke e thelluar dhe konkretizuar më tej këtë aspekt të veprimtarisë institucionale.

Nevoja për një plan të veçantë u motivua nga një sërë rrethanash dhe faktorësh, e mes tjerash ndërlidhen me nevojën që duhet një dokument i veçantë për të trajtuar dhe prioritetizuar këtë fushë të rëndësishme të fushëveprimit ligjor dhe institucional të Akademisë, duke e zgjeruar edhe më tej gamën e objektivave dhe nën-objektivave dhe aktiviteteve, për të arritur qëllime më të mëdha strategjike. Pastaj, standardet e reja të akreditimit kërkojnë që institucioni duhet ta ketë një dokument të veçantë strategjik lidhur me hulumtimet shkencore. Gjithashtu, ky aspekt u pa si i nevojshëm për priorizim të objektivave, që edhe më tutje të vlerësohet si tejet e rëndësishme dimensionin hulumtues dhe shkencor, i ndërlidhur me aspektet akademike dhe profesionale, të gjitha këto me interes të sistemit të sigurisë publike në Republikën e Kosovës.

I.2. Lidhja me politikat kombëtare të arsimit të lartë, hulumtimit shkencor dhe sigurisë

Ky plan strategjik përveç që bazën e gjen tek Strategjia Zhvillimore e AKSP dhe si vazhdimësi e shtyllës institucionale dhe ligjore të hulumtimeve, edhe në rrafshin kombëtar është një instrument që ndërlidhet fuqishëm me dy dokumente të rëndësishme strategjike nacionale, përkatësisht me Strategjinë e Arsimit 2022-2026 dhe Strategjinë Kombëtare të Sigurisë së Kosovës 2022-2027. Gjendja e hulumtimeve shkencore, përkatësisht nevoja që hulumtimet të integrohen fuqishëm në mësimdhënie, në hulumtime dhe publikime cilësore, si dhe të materializohet në produkte shkencore të nevojshme për politika dhe nevoja publike, është një shqetësim kombëtar. Në këtë drejtim, nuk shpëton as Akademia nga një gjendje e tillë e fokusit hulumtues shkencor. Në të diskutuarit dhe të kontribuarit lidhur me aspektet e hulumtimeve shkencore në Kosovë është përfshirë edhe Akademia e Shkencave të Kosovës e cila bazuar në një dokument publik të hartuar me ndihmën e disa ekspertëve të dalluar, thekson nevojën e shtrirjes së konceptit të hulumtimeve për nevoja shoqërore, përkatësisht në një nga rekomandimet kryesore nënvizohet që: *“Institucionet hulumtuese të shtjellojnë projekte si përgjigje ndaj problemeve shoqërore në funksion të zhvillimit shoqëror, kulturor, ekonomik e politik të vendit.”*¹

Në ndërlidhje me Strategjinë e Arsimit 2022-2026,² njësoj si në nivel kombëtar, edhe në Akademi vërehet se pjesa e konsiderueshme e publikimeve shkencore mbështetet në iniciativa individuale. Kjo e bën që aktiviteti hulumtues të mos arrijë potencialin e plotë në gjenerimin e dijes së re dhe në ofrimin e kontributit të strukturuar akademik, shkencor apo profesional. Për këtë arsye, është e domosdoshme që hulumtimet dhe publikimet shkencore të fokusohen në fushën e sigurisë publike, në përputhje me prioritetet dhe temat hulumtuese kryesore të kësaj fushe, duke i dhënë Akademisë rolin udhëheqës në prodhimin e njohurive shkencore që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në politikë-bërje dhe në forcimin e institucioneve të sigurisë publike.

Strategjia e Sigurisë së Kosovës 2022-2027³ përcakton qartë interesat jetike të vendit, sikurse: mbrojtja e sovranitetit; ruajtja e rendit kushtetues dhe sigurisë publike; forcimi i sigurisë njerëzore dhe zhvillimit shoqëror, si dhe integrimet euro-atlantike dhe mekanizmat e tjerë ndërkombëtarë.

¹ Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës. (2021). *Platformë për rimëkëmbjen e arsimit në Kosovë*. Prishtinë.

² Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit. (2022). *Strategjia e Arsimit 2022-2026*. <https://masht.rks-gov.net/strategjia-e-arsimit2022-2026/ax>

³ Qeveria e Kosovës (2022). *Strategjia e Sigurisë e Kosovës 2022 - 2027*. <https://kryeministri.rks-gov.net/ep-content/uploads/2022/10/1-Strategjia-e-Sigurise-e-Kosoves-ALB.pdf>

Të gjitha këto fusha kërkojnë politika dhe veprime të bazuara në të dhëna të besueshme, gjë që krijon një lidhje të drejtpërdrejtë me rolin e Akademisë si institucion i arsimit të lartë dhe hulumtimit. Përmes hulumtimeve shkencore, Akademia mund të kontribuojë në analizimin e kërcënimeve aktuale, si krimi i organizuar, korrupsioni, ekstremizmi i dhunshëm dhe kërcënimet kibernetike, duke zhvilluar projekte hulumtuese shkencore individuale dhe ekipore. Po ashtu, fusha si menaxhimi i emergjencave, siguria mjedisore, transformimi digjital dhe mbrojtja e infrastrukturës kritike, janë fusha ku hulumtimi shkencor mund të jep një kontribut të rëndësishëm.

II. MISIONI, VIZIONI DHE VLERAT

II.1. Misioni

Ofrimi i hulumtimeve shkencore cilësore në fushën e sigurisë publike, të orientuara drejt ndikimit praktik dhe ndërkombëtarizimit, me qëllim që rezultatet e tyre të kontribuojnë në politikë-bërje, zhvillim akademik dhe rritjen e sigurisë publike në Republikën e Kosovës.

II.2. Vizioni

Akademia të bëhet institucion kredibil dhe me ndikim në fushën e hulumtimeve shkencore për sigurinë publike, duke ndërtuar një kulturë të qëndrueshme hulumtuese, të njohur për cilësi, ndikim praktik dhe integrim në rrjetet ndërkombëtare shkencore.

II.3. Vlerat

Plani strategjik bazohet në këto vlera:

- 1) Ekselenca shkencore** - Përkushtimi profesional për hartimin, zhvillimin dhe publikimin e punimeve shkencore me cilësi të lartë dhe ndikim të matshëm, duke kontribuar në avancimin e fushës së sigurisë publike.
- 2) Integriteti akademik** - Zhvillimi i hulumtimeve shkencore mbi bazën e parimeve të ndershmërisë, transparencës dhe përgjegjësisë shkencore, duke respektuar standardet, rregullat dhe protokollet e etikës së hulumtimit shkencor.
- 3) Bashkëpunimi** - Nxitja e partneriteteve ndërmjet institucioneve të sigurisë publike dhe atyre akademike e shkencore, si në nivel vendor ashtu edhe në atë ndërkombëtar.
- 4) Inovacioni dhe aplikueshmëria** - Shndërrimi i rezultateve të hulumtimeve shkencore produkte të mëtutjeshme, sikurse janë manualet, udhëzuesit, si dhe qasje inovative për nevojat e institucioneve të sigurisë publike.
- 5) Qëndrueshmëria institucionale** - Ndërtimi i kapaciteteve afatgjata për hulumtime, përmes angazhimit të stafit akademik, përfshirjes së studentëve dhe hulumtuesve të rinj, si dhe zhvillimit e mirëmbajtjes së infrastrukturës bashkëkohore hulumtuese.

III. ANALIZA E GJENDJES AKTUALE

III.1. Gjendja aktuale

Në një hark kohor prej pesë vitesh, d.m.th. nga viti 2020 deri tani, stafi akademik me orar të plotë ka publikuar punime shkencore në fusha dhe tema të ndryshme të sigurisë publike dhe ka marrë pjesë në konferenca shkencore të ndryshme, brenda dhe jashtë vendit. Shumica e publikimeve shkencore janë publikuar në revista të cilat janë të mbuluara nga platforma Scopus apo edhe Web of Science. Temat e publikuara prekin disa fusha të sigurisë publike dhe tema të saj, e veçanërisht: krimet mjedisore; krimet kibernetike dhe siguria digjitale; migracioni i parregullt dhe kontrabanda me migrantë; terrorizmi dhe të drejtat e viktimave; fenomenet sociale dhe sjelljet devijuese dhe aspektet korrektuese. Në emër të Akademisë së Kosovës për Siguri Publike për periudhën 2020 - 2025 janë publikuar 12 punime shkencore të cilat janë të indeksuara në Scopus.

Aktualisht në AKSP është duke u zhvilluar projekti shkencor i përkrahur nga MASHT sipas vendimit nr. 2/2282. Projekti shkencor i përkrahur nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, ku bartës i projektit shkencor është Prof. Asoc. Vilard Bytyqi, ky projekt shkencor titullohet: *“Zbatimi i standardeve të Konventës së Stambollit në fushën e hetimeve, ndjekjes penale dhe masave mbrojtëse në Republikën e Kosovës”*. Në këtë projekt të rëndësishëm shkencor janë të përfshirë anëtar të stafit akademik, ekspertë të jashtëm ndërkombëtar dhe studentë.

III.2. Struktura, burimet njerëzore dhe infrastruktura

III.2.1. Struktura

Akademia për herë të parë ofron arsim të lartë në fushën e sigurisë publike nga viti 2014. Në kuadër të strukturës së saj organizative funksionon Fakulteti i Sigurisë Publike i cili zhvillon programe të arsimit të lartë, hulumtimit dhe zhvillimit në fushën e sigurisë publike. Deri më tani, Akademia ka ofruar arsimim të lartë në fushën e sigurisë publike në nivelin bachelor, ndërsa është bërë një studim fizibiliteti për programin master, ku është konfirmuar se ekziston nevoja, por edhe mundësia që të zhvillohet një program master në fushën e sigurisë publike.

Bazuar edhe në Rregulloren nr. 05/2019 të Arsimit të Lartë në AKSP, të nxjerrë nga Qeveria, një nga detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të Fakultetit është hulumtimi dhe zhvillimi në fushën e sigurisë publike (neni 5, paragr. 1.3). Misioni i Fakultetit është të ofrojë shërbime cilësore të

arsimit, hulumtimit dhe zhvillimit për siguri publike në Republikën e Kosovës (neni 6). Fakulteti i Sigurisë Publike ka në strukturën e saj organizative Institutin për Hulumtim dhe Zhvillim (neni 9 paragr. 1.3). Detyrat dhe përgjegjësitë e Institutit të Hulumtimit dhe Zhvillimit janë: Hulumtimi dhe zhvillimi në fushën e sigurisë publike; Mbështetja e personelit dhe vijuesve në aktivitet e tyre hulumtuese; Mbështetja e personelit dhe vijuesve lidhur me metodologjinë e hulumtimit shkencor; Hartimi i projekt propozimeve dhe aplikimi për financimin nga jashtë për projektet e hulumtimit dhe zhvillimit në fushën e sigurisë publike; Bashkëpunimi me institucionet e tjera të hulumtimit dhe zhvillimit të arsimit të lartë dhe institucioneve të sigurisë publike (neni 11).

III.3.1. Burimet njerëzore

Detyrat e stafit akademik janë të rregulluara me aktet juridike të zbatueshme në AKSP dhe kontratën individuale të punësimit. Detyrat dhe përgjegjësitë e tyre kryesore përfshijnë mësimdhënien, hulumtimin shkencor, zhvillimin e kurrikulave, si dhe detyra tjera akademike dhe administrative. Këtu është një përmbledhje e përgjithshme e detyrave të tyre:

- **Mësimdhënia:** Stafi akademik është përgjegjës për zhvillimin dhe realizimin e ligjëratave, seminareve dhe ushtrimeve praktike në programet e arsimit të lartë. Ata hartojnë dhe përditësojnë materialet mësimore, përdorin metoda bashkëkohore të mësimdhënies dhe vlerësojnë performancën e studentëve përmes provimeve, detyrave, projekteve dhe formave të tjera të vlerësimit. Përveç kësaj, ofrojnë këshillim akademik për studentët lidhur me progresin studimor, përzgjedhjen e lëndëve dhe zhvillimin e tyre të karrierës.
- **Hulumtimi shkencor:** Stafi akademik angazhohet në aktivitete hulumtuese duke përfshirë mbledhjen, përpunimin dhe analizimin e të dhënave, hartimin dhe dërgimin për publikim të punimeve shkencore, si dhe aplikimin për grante hulumtuese. Ata marrin pjesë në projekte të përbashkëta shkencore, bashkëpunojnë në nisma ndërdisiplinore dhe kontribuojnë në avancimin e njohurive në fushën e tyre. Po ashtu, mbikëqyrin projektet hulumtuese të studentëve dhe inkurajojnë përfshirjen e tyre në aktivitete shkencore.
- **Zhvillimi i kurrikulave:** Stafi akademik kontribuon në zhvillimin dhe përmirësimin e kurrikulave përmes dhënies së sugjerimeve, ofrimit të ekspertizës nga fusha përkatëse dhe pjesëmarrjes në proceset e konsultimit në përputhje me standardet e akreditimit.

- **Detyrat tjera administrative dhe akademike:** Stafi akademik merr pjesë në detyra të ndryshme administrative brenda fakultetit dhe Akademisë, si shërbimi në komisione, grupe punuese dhe organe kolegjiale. Ata mund të angazhohen në koordinimin e programeve, proceset e akreditimit dhe aktivitetet e vlerësimit akademik. Përveç kësaj, stafi akademik duhet të zhvillojë vazhdimisht aftësitë profesionale përmes pjesëmarrjes në konferenca, trajnime dhe punëtori, me qëllim rritjen e cilësisë në mësimdhënie, hulumtime dhe menaxhim akademik.

Në përgjithësi, stafi akademik duhet të luajë një rol thelbësor në avancimin e misionit të Akademisë dhe Fakultetit, duke nxitur ekselencën në mësimdhënie, hulumtim shkencor dhe shërbim ndaj komunitetit akademik dhe shoqërisë në përgjithësi.

Stafi akademik i punësuar me orar të plotë në Fakultetin e Sigurisë Publike është si në vijim.

Nr.	Emri dhe mbiemri	Titulli akademik
1.	Dr. Vilard Bytyqi	Profesor i Asocuar
2.	Dr. Ferid Azemi	Profesor Asistent
3.	Dr. Halil Asllani	Profesor Asistent
4.	Dr. Fidair Berisha	Profesor Asistent
5.	Dr. Anita Zenuni	Ligjëruese
6.	Ma. Sc. Florentina Shala Braha Phd. cand	Ligjëruese

Tabela 1. Stafi akademik me kontratë të rregullt i FSP i evidentuar në vitin 2025

III.3.2 Infrastruktura

Për qëllime të punës akademike dhe shkencore, Akademia është e pajisur me hapësira të ndryshme të përshtatura për mësimdhënie, analiza, hulumtime dhe qëllime administrative. Këto përfshijnë klasat, amfiteatri, laboratorët dhe hapësirat e zyrave. Të gjitha këto janë pronësi e Akademisë. Laboratorët e Akademisë përfshijnë hapësira simuluese të avancuara, si vend-ngjarja kriminalistike e ndërtuar me të gjitha elementet reale të një skene krimi me viktimë, sistemi FATS për simulimin e përdorimit të armëve të zjarrit dhe laboratorin e qytetit imagjinar, ku në një hapësirë klase është vendosur infrastruktura e një qyteti të vogël, e cila shërben për trajnime praktike dhe hulumtime shkencore në fushën e sigurisë publike.

IV. FUSHAT KRYESORE TË HULUMTIMIT NË SIGURINË PUBLIKE

Akademia është e orientuar drejt disa fushave kyçe të hulumtimit, të cilat përbëjnë baza të rëndësishme për zhvillimin e sigurisë publike. Synimi është që rezultatet e hulumtimit të shndërrohen në politika publike, standarde profesionale dhe qasje inovative për avancimin e sigurisë publike dhe rritjes së cilësisë së shërbimeve për qytetarët. Rezultatet do të reflektohen në projekte hulumtuese, publikime shkencore, konferenca, si dhe aktivitete të rëndësishme shkencore.

IV.1. Fusha 1 - Politikat dhe qeverisja e sigurisë publike

- Kornizat ligjore dhe strategjitë kombëtare për sigurinë publike;
- Politikat shtetërore për sigurinë kufitare, kriminalitetin, emergjencat, krimin e organizuar dhe terrorizmin.
- Edukimi dhe trajnimi i personelit të agjencive të sigurisë;
- Bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar në politikat e sigurisë;
- Dimensioni gjinor dhe përfshirja e barazisë në politikat e sigurisë.
- Përdorimi i inteligjencës artificiale në fushën e sigurisë publike

IV.2. Fusha 2 - Rendi publik dhe siguria kufitare

- Politikat dhe korniza ligjore për menaxhimin e rendit publik dhe kufijve;
- Praktikat e menaxhimit të rendit publik dhe kontrolleve kufitare;
- Kontrolli doganor dhe parandalimi i kontrabandës, trafikimit dhe krimeve ekonomike;
- Modelet e policimit: tradicional, komunitar, inteligjent dhe digjital;
- Përdorimi i forcës dhe respektimi i të drejtave të njeriut;
- Etika dhe integriteti profesional në sigurinë publike;
- Bashkëpunimi ndërinstitucional, ndërkombëtar dhe me komunitetin.

IV.3. Fusha 3 - Menaxhimi i krizave dhe emergjencave

- Fatkeqësitë natyrore dhe aksidentet teknologjike si sfida për sigurinë publike;
- Planet emergjente dhe kapacitetet institucionale të reagimit;
- Ndikimi i ndryshimeve klimatike dhe rreziqeve të lidhura;
- Ushtrimet e simulimeve dhe përgatitja e qytetarëve për reagim;
- Përdorimi i teknologjisë dhe sistemeve të paralajmërimit të hershëm;

- Menaxhimi i logjistikës dhe burimeve gjatë krizave;
- Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe rajonal në fushën e emergjencave;
- Trauma kolektive, stresi post-traumatik dhe përballja sociale pas krizave.

IV.4. Fusha 4 - Kriminaliteti dhe strategjitë e parandalimit

- Krimi i organizuar dhe ndikimi i tij në sigurinë publike;
- Trafiku i drogës, armëve, njerëzve dhe mallrave të rrezikshme;
- Recidivizmi dhe politikat e ri-integrimit;
- Krimet ekonomike: korrupsioni, pastrimi i parave, mashtrimet fiskale;
- Kriminaliteti i të miturve dhe të rinjve;
- Krimet e dhunshme dhe faktorët që i nxisin ato;
- Krimet mjedisore dhe ndikimi i tyre në sigurinë publike;
- Dhuna në familje, varfëria, pabarazitë sociale dhe implikimet për sigurinë.

IV.5. Fusha 5 –Krimet kibernetike dhe siguria digjitale

- Kërcënimet kibernetike ndaj infrastrukturës kritike;
- Siguria digjitale dhe mbrojtja e integruar e sistemeve;
- Krimet online: mashtrimet financiare, pornografia e fëmijëve, vjedhja e identitetit;
- Dez-informimi dhe propagandat digjitale, përfshirë fushatat hibride;
- Abuzimet digjitale gjatë krizave dhe emergjencave;
- Korniza ligjore për privatësinë dhe mbrojtjen kibernetike;
- Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe standardet globale të sigurisë digjitale;
- Varësia digjitale dhe ndikimi i saj në sjelljet shoqërore dhe kriminalitet.

IV.6. Fusha 6 - Radikalizmi, ekstremizmi i dhunshëm dhe terrorizmi

- Fenomeni i radikalizmit dhe shkaqet e tij;
- Ekstremizmi i dhunshëm dhe ndikimi në sigurinë publike;
- Format dhe tendencat e terrorizmit bashkëkohor;
- Strategjitë e parandalimit, de-radikalizimit dhe ri-integrimit;
- Përdorimi i teknologjisë digjitale dhe propagandës online;
- Korniza ligjore dhe standardet ndërkombëtare kundër terrorizmit;
- Të drejtat e njeriut dhe balanca me masat kundër terrorizmit;

- Viktimat e terrorizmit dhe mbështetja institucionale/sociale për to.

IV.7. Fusha 7 - Korrektimi dhe sprovimi

- Roli i Shërbimit Korrektues dhe Sprovues në sigurinë publike;
- Kushtet e burgjeve dhe ndikimi në sjelljet e të dënuarve;
- Vetëvrasjet dhe sjelljet vetë-dëmtuese në institucione korrektuese;
- Stresi dhe burnout-i tek oficerët korrektues;
- Programet e rehabilitimit dhe risocializimit të të dënuarve;
- Trajtimi i personave me çrregullime mendore në sistemin korrektues;
- Politikat për rikthimin e të dënuarve në shoqëri.

V. NDËRLIDHJA E FUSHAVE HULUMTUESE ME STANDARDET DHE NORMAT NDËRKOMBËTARE

Fushat e hulumtimit në sigurinë publike, të përcaktuara nga Akademia, nuk janë të izoluara, por të ndërlidhura ngushtë me standardet dhe normat ndërkombëtare që udhëheqin praktikën dhe zhvillimin shkencor në këtë fushë. Kjo qasje siguron që hulumtimi i zhvilluar në Akademi të jetë i krahasueshëm, i njohur dhe i zbatueshëm edhe në kontekstin rajonal apo global. Kornizat normative ndërkombëtare, si Konventat e OKB-së, Konventat e Këshillit të Evropës, dokumentet strategjike dhe juridike të BE-së, si dhe standardet e organizatave ndërkombëtare profesionale (si ISO, WCO, OSBE, OBSH), përcaktojnë parime, udhëzime dhe praktika që janë të detyrueshme ose të rekomanduara për shtetet dhe institucionet e tyre të sigurisë publike. Duke i lidhur drejtpërdrejt fushat hulumtuese me këto instrumente ndërkombëtare, Akademia siguron që rezultatet shkencore të shërbejnë si bazë për politika publike, legjislacion, trajnime profesionale dhe mekanizma institucionalë në përputhje me standardet ndërkombëtare. Për më tepër, kjo ndihmon që hulumtimet të kontribuojnë drejtpërdrejt integritit evropian të Kosovës, duke harmonizuar praktikën vendore me standardet dhe kërkesat e BE-së, si dhe të organizatave ndërkombëtare.

Në këtë mënyrë, rezultatet e punës shkencore të Akademisë mund të përdoren jo vetëm nga institucionet vendore të sigurisë, por edhe nga partnerët ndërkombëtarë në projekte të përbashkëta, duke rritur rolin e Kosovës në rrjetet akademike dhe profesionale të sigurisë publike. Kështu, çdo fushë hulumtimi që Akademia ka përcaktuar, nga politikat e sigurisë dhe menaxhimi i rendit publik, deri te krimet kibernetike, radikalizmi dhe aspektet korrektuese, është e bazuar në standarde dhe norma të pranura ndërkombëtarisht. Kjo garanton që hulumtimet të jenë të besueshme, të qëndrueshme dhe të aplikueshme në praktikën moderne të sigurisë publike.

Në vijim paraqiten fushat kryesore të hulumtimit dhe standardet ndërkombëtare me të cilat ato janë të ndërlidhura.

V.1. Fusha 1 - Politikat dhe qeverisja e sigurisë publike

- Strategjia e Sigurisë e Bashkimit Evropian;⁴

⁴ European Parliament. (2021). European Parliament resolution of 17 December 2020 on the EU Security Union Strategy (2020/2791(RSP)) (2021/C 445/17). Official Journal of the European Union, C 445, 140-147. <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:52020IP0378>

- Korniza e politikave për qeverisje të shëndoshë publike: Karakteristikat bazë të qeverive që funksionojnë mirë;⁵
- ESG - Standardet dhe udhëzimet evropiane për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë ;⁶
- Standardet e Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit ose Dënimit Çnjerëzor apo Poshtërues;⁷

V.2. Fusha 2 - Rendi publik dhe siguria kufitare

- Policimi demokratik;⁸
- Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut;⁹
- Kodi i Kufijve Shengen;¹⁰
- Plani orientues për doganat i Komisionit Evropian;¹¹
- Parimet për përdorimin e forcës dhe të armëve nga zyrtarët e zbatimit të ligjit;¹²
- Kodi i sjelljes për zyrtarët e zbatimit të ligjit;¹³
- Strategjia e BE-së për menaxhimin e rrezikut doganor;¹⁴
- Korniza e standardeve të WCO SAFE për sigurimin dhe lehtësimin e tregtisë globale¹⁵

V.3. Fusha 3 - Menaxhimi i krizave dhe emergjencave

- Korniza e Sendait për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë 2015-2030;¹⁶
- Mekanizmi i mbrojtjes civile të BE-së;¹⁷

⁵ OECD (2020), Policy Framework on Sound Public Governance: Baseline Features of Governments that Work Well, OECD Publishing, Paris, <https://doi.org/10.1787/c03e01b3-en>

⁶ https://www.enqa.eu/wp-content/uploads/2015/11/ESG_2015.pdf

⁷ <https://www.coe.int/en/web/cpt/standards>

⁸ Organization for Security and Co-operation in Europe. (2008). Guidebook on Democratic Policing (2nd ed., Senior Police Adviser to the OSCE Secretary General). <https://www.osce.org/files/f/documents/5/3/23804.pdf>

⁹ Council of Europe. (1950). European Convention on Human Rights (ETS No. 005). Council of Europe Treaty Series. https://www.echr.coe.int/documents/convention_eng.pdf

¹⁰ <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32016R0399>

¹¹ European Commission: Directorate-General for Taxation and Customs Union, Customs blueprints - Pathways to better customs, Publications Office, 2015, <https://data.europa.eu/doi/10.2778/77704>

¹² <https://www.ohchr.org/sites/default/files/firearms.pdf>

¹³ United Nations General Assembly. (1979, December 17). Code of Conduct for Law Enforcement Officials (A/RES/34/169). United Nations. <https://www.ohchr.org/en/instruments-mechanisms/instruments/code-conduct-law-enforcement-officials>

¹⁴ <https://www.consilium.europa.eu/media/24955/146030.pdf>

¹⁵ World Customs Organization. (2021). WCO SAFE framework of standards to secure and facilitate global trade. Brussels. <https://www.wcoomd.org/-/media/wco/public/global/pdf/topics/facilitation/instruments-and-tools/tools/safe-package/safe-framework-of-standards.pdf?la=en&la=en&la=en&la=en>

¹⁶ https://www.unisdr.org/files/43291_sendaiframeworkfordrren.pdf

¹⁷ <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=SWD:2025:545:FIN>

- Udhëzimet e OBSH-së për Gatishmërinë dhe Reagimin ndaj Emergjencave;¹⁸
- ISO 22320:2018 Siguria dhe Qëndrueshmëria - Udhëzime për Menaxhimin e Emergjencave;¹⁹

V.4. Fusha 4 - Kriminaliteti dhe strategjitë e parandalimit

- Konventa e OKB kundër krimit të organizuar ndërkombëtar dhe protokollet përkatëse;²⁰
- Konventa e OKB kundër korrupsionit;²¹
- Konventa e OKB për pastrimin, kërkimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e produkteve të krimit dhe për financimin e terrorizmit;²²
- Standardet e BE-së mbi ngrirjen dhe konfiskimin e mjeteve dhe produkteve të krimit në Bashkimin Evropian;²³
- Udhëzimet Evropiane dhe të OKB-së për drejtësinë për të mitur;

V.5. Fusha 5 - Krimet kibernetike dhe siguria digjitale

- Konventa e Budapestit për krimin kibernetikë;²⁴
- Standardet ndërkombëtare për përpunimin e të dhënave personale;²⁵
- Manuali i Talinit mbi të drejtën ndërkombëtare të zbatueshme në operacionet kibernetike;²⁶

¹⁸ <https://iris.who.int/bitstream/handle/10665/350838/9789240037182-eng.pdf?sequence=1>

¹⁹ International Organization for Standardization. (2018). ISO 22320:2018 Security and resilience — Emergency management - Guidelines. <https://www.iso.org/standard/67851.html>

²⁰ Organizata e Kombeve të Bashkuara. (2004). Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar dhe Protokollet Përkatëse. OKB. <https://www.unodc.org/unodc/en/organized-crime/intro/UNTOC.html>

²¹ Organizata e Kombeve të Bashkuara. (2004). Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit. https://www.un.org/en/ethics/assets/pdfs/UN_Convention_Against_Corruption.pdf

²² Council of Europe. (2005). Council of Europe Convention on Laundering, Search, Seizure and Confiscation of the Proceeds from Crime and on the Financing of Terrorism (CETS No. 198). Council of Europe Treaty Series. <https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list?module=treaty-detail&treatynum=198>

²³ European Parliament, & Council of the European Union. (2014). Directive 2014/42/EU of the European Parliament and of the Council of 3 April 2014 on the freezing and confiscation of instrumentalities and proceeds of crime in the European Union. Official Journal of the European Union, L 127, 39-50. <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX:32014L0042>

²⁴ Council of Europe. (2001). Convention on Cybercrime (ETS No. 185). European Treaty Series. <https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list?module=treaty-detail&treatynum=185>

²⁵ European Parliament, & Council of the European Union. (2016). Regulation (EU) 2016/679 of the European Parliament and of the Council of 27 April 2016 on the protection of natural persons with regard to the processing of personal data and on the free movement of such data, and repealing Directive 95/46/EC (General Data Protection Regulation). Official Journal of the European Union, L 119, 1-88. <https://eur-lex.europa.eu/eli/reg/2016/679/oj>

²⁶ Schmitt, M. N. (Ed.). (2017). Tallinn Manual 2.0 on the international law applicable to cyber operations. Cambridge University Press. <https://doi.org/10.1017/9781316822524>

- ISO/IEC 27001 - Standardi për sigurinë e informacionit;²⁷
- Akti i BE-së për sigurinë kibernetike (2019);²⁸
- Korniza e NIST për sigurinë kibernetike;²⁹
-

V.6. Fusha 6 - Radikalizmi, ekstremizmi i dhunshëm dhe terrorizmi

- Strategjia globale e OKB kundër terrorizmit;³⁰
- Parimet udhëzuese mbi luftëtarët e huaj terroristë: Parimet Udhëzuese të Madridit 2015;³¹
- Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin e terrorizmit;³²
- Strategjia e BE-së për luftimin e radikalizimit dhe rekrutimit në terrorizëm;³³
- Standardet e Task Forcës për veprim financiar (FATF) kundër financimit të terrorizmit;³⁴
- Rezolutat e Këshillit për të Drejtat e Njeriut i OKB-së mbi luftën kundër terrorizmit dhe të drejtat e njeriut.³⁵

²⁷ International Organization for Standardization, & International Electrotechnical Commission. (2022). ISO/IEC 27001:2022 Information security, cybersecurity and privacy protection — Information security management systems — Requirements. ISO. <https://www.iso.org/standard/82875.html>

²⁸ European Parliament, & Council of the European Union. (2019). Regulation (EU) 2019/881 of the European Parliament and of the Council of 17 April 2019 on ENISA (the European Union Agency for Cybersecurity) and on information and communications technology cybersecurity certification and repealing Regulation (EU) No 526/2013 (Cybersecurity Act). Official Journal of the European Union, L 151, 15-69. <https://eur-lex.europa.eu/eli/reg/2019/881/oj>

²⁹ National Institute of Standards and Technology. (2018). Framework for improving critical infrastructure cybersecurity, version 1.1. <https://doi.org/10.6028/NIST.CSWP.04162018>

³⁰ United Nations General Assembly. (2006). The United Nations Global Counter-Terrorism Strategy: Resolution adopted by the General Assembly on 8 September 2006 (A/RES/60/288). United Nations. <https://undocs.org/A/RES/60/288>

³¹ Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara. (2019). Parimet udhëzuese mbi luftëtarët e huaj terroristë: Parimet Udhëzuese të Madridit 2015 + Shtojca e vitit 2018 (S/2015/939 dhe S/2018/1177). <https://www.un.org/securitycouncil/ctc/sites/www.un.org.securitycouncil.ctc/files/security-council-guiding-principles-on-foreign-terrorist-fighters.pdf>

³² Council of Europe. (2005). Council of Europe Convention on the Prevention of Terrorism (CETS No. 196). Council of Europe Treaty Series. <https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list?module=treaty-detail&treatynum=196>

³³ Council of the European Union. (2005). The European Union strategy for combating radicalisation and recruitment to terrorism (14781/1/05 REV 1). Council of the European Union. <https://data.consilium.europa.eu/doc/document/ST-14781-2005-REV-1/en/pdf>

³⁴ Financial Action Task Force. (2012). International standards on combating money laundering and the financing of terrorism & proliferation: The FATF recommendations. FATF/OECD. <https://www.fatf-gafi.org/recommendations.html>

³⁵ United Nations Human Rights Council. (2013, March). Resolution 22/8: Protection of human rights and fundamental freedoms while countering terrorism: Mandate of the Special Rapporteur on the promotion and protection of human rights and fundamental freedoms while countering terrorism (A/HRC/RES/22/8). Human Rights Council, 22nd session. <https://www.right-docs.org/doc/a-hrc-res-22-8/>

V.7. Fusha 7 - Korrektimi dhe sprovimi

- Rregullat Nelson Mandela;³⁶
- Rregullat evropiane të burgjeve;³⁷
- Rregullat e Këshillit të Evropës për Shërbimin Sprovues;³⁸
- Rregullat e Bangkok-ut;³⁹
- Rregullat e Tokios;⁴⁰
- Udhëzuesi i OKB-së për parandalimin e recidivizmit dhe ri-integrimin e të dënuarve.⁴¹

³⁶ United Nations General Assembly. (2015). United Nations Standard Minimum Rules for the Treatment of Prisoners (the Nelson Mandela Rules) (A/RES/70/175). United Nations. <https://undocs.org/A/RES/70/175>

³⁷ Council of Europe. (2020). Recommendation CM/Rec(2006)2 of the Committee of Ministers to member States on the European Prison Rules (adopted on 11 January 2006 and revised on 1 July 2020). Council of Europe. https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectId=09000016809ee581

³⁸ Council of Europe. (2010). Recommendation CM/Rec(2010)1 of the Committee of Ministers to member States on the Council of Europe Probation Rules (adopted on 20 October 2010). Council of Europe. https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectId=09000016805cfbc7

³⁹ United Nations General Assembly. (2010). United Nations Rules for the Treatment of Women Prisoners and Non-custodial Measures for Women Offenders (the Bangkok Rules) (A/RES/65/229). United Nations. https://www.unodc.org/documents/justice-and-prison-reform/Bangkok_Rules_ENG_22032015.pdf

⁴⁰ United Nations General Assembly. (1990, December 14). United Nations Standard Minimum Rules for Non-custodial Measures (The Tokyo Rules) (A/RES/45/110). United Nations. <https://www.ohchr.org/Documents/ProfessionalInterest/tokyorules.pdf>

⁴¹ United Nations Office on Drugs and Crime. (2018). Introductory handbook on the prevention of recidivism and the social reintegration of offenders. United Nations. https://www.unodc.org/documents/justice-and-prison-reform/crimeprevention/Introductory_Handbook_on_the_Prevention_of_Recidivism_and_the_Social_Reintegration_of_Offenders.pdf

VI. OBJEKTIVAT STRATEGJIKË

Plani strategjik për hulumtimet shkencore në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike 2026-2028 përcakton tre objektiva strategjike, të ndërlidhur ngushtë me misionin e fakultetit dhe Akademisë dhe me nevojat zhvillimore në fushën e sigurisë publike.

Secili objektiv është konceptuar duke u bazuar në gjendjen aktuale, prioritetet kombëtare dhe ndërkombëtare të hulumtimit, si dhe nevojën për të forcuar lidhjen mes shkencës dhe praktikës profesionale. Objektivat zërthehen më tej në objektiva specifike dhe aktivitete konkrete, të cilat shoqërohen me tregues të matshëm për monitorimin e progresit. Kjo qasje siguron që zbatimi i planit strategjik të mos mbetet në nivel deklarativ, por të përkthehet në veprime të qarta dhe rezultate të prekshme.

Në vijim paraqiten objektivat strategjike, secili i shoqëruar me përshkrimin e qëllimit të tij dhe me aktivitetet që do të ndërmerren për realizim, ndërsa plani i veprimit përmban ndarjen e detajuar të tyre sipas periudhave kohore, njësive përgjegjëse dhe burimeve të financimit.

Objektivat e përgjithshme strategjike janë:

OBJEKTIVI 1: Rritja e produktivitetit shkencor në fushën e sigurisë publike

OBJEKTIVI 2: Rritja e numrit të projekteve hulumtuese në fushën e sigurisë publike

OBJEKTIVI 3: Zhvillimi i platformave shkencore për prezantim dhe publikim në fushën e sigurisë publike dhe forcimi i kapaciteteve institucionale për menaxhimin e hulumtimeve

VI.1. OBJEKTIVI 1: Rritja e produktivitetit shkencor në fushën e sigurisë publike

Ky objektivi synon të adresojë sfidën e sigurimit të fondeve për botime dhe pjesëmarrje në konferenca, krijimin e një mjedisi stimulues përmes mentorimit dhe trajnimeve, si dhe përfshirjen e studentëve në proceset hulumtuese. Përmes adresimit të këtyre çështjeve synohet të krijohet një kulturë e qëndrueshme shkencore. Rezultati i pritur është rritja e dukshmërisë së Akademisë në nivel kombëtar e ndërkombëtar, publikimi i punimeve të indeksuara në data-bazat e rëndësishme, sikurse janë Scopus dhe WoS dhe zhvillimi i kapaciteteve të brendshme hulumtuese që i japin vlerë shkencore, akademike dhe praktike fushës së sigurisë publike.

Kjo pjesë është e harmonizuar edhe me politikat që është duke ndjekur Akademia në drejtim të hartimit dhe zbatimit të rregulloreve përkatëse për rregullimin e veprimtarisë shkencore në Akademi, ku aty mes tjerash parashihen kushtet, procedurat dhe kriteret për nxitjen e produktivitetit shkencor në fushën e sigurisë publike. Në këtë drejtim, disa nga sfidat e identifikuar ndër vite, kanë për qëllim të adresohen përmes një mekanizmit të qëndrueshëm, e që ndërlidhet me sigurimin e resurseve të nevojshme për përmbushjen e agjendës shkencore që ka Akademia, sigurimin e fondeve të mjaftueshme për mbështetje, si dhe krijimin dhe mirëmbajtjen e platformave për prezantimin dhe publikimin e punës shkencore.

Marrë në konsideratë që arsimi i lartë është i ndërlidhur drejtpërdrejt në cilësinë e hulumtimeve, pastaj kërkesat e domosdoshme që librat universitarë të jenë të qasshëm dhe të jenë të gatshëm për studim, Akademia po ndjek një politikë të atillë që brenda një kohë të sigurohet literatura e nevojshme me tituj të librave dhe botimeve nga vet stafi akademik, por edhe sigurimin e përkthimeve për librat kryesor të fushës së sigurisë publike për mbulimin e programeve studimor me literaturë relevante dhe cilësore..

Në kuadër të këtij objektivi strategjik për arritjen e tij janë paraparë këto objektiva specifike:

- 1.1. Mbështetja financiare për publikime me cilësi dhe ndikim të lartë;
- 1.2. Pjesëmarrja në projekte kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare;
- 1.3. Mobiliteti akademik dhe pjesëmarrja në konferenca, seminare e punëtori;
- 1.4. Krijimi i një mjedisi stimulues hulumtues përmes mentorimit, trajnimeve dhe qasjes në burime shkencore bashkëkohore;
- 1.5. Botimi i librave universitarë, monografive dhe manualeve praktike;

VI.2. OBJEKTIVI 2: Rritja e numrit të projekteve hulumtuese në fushën e sigurisë publike

Përfshirja e kufizuar e Akademisë në projekte hulumtuese është një nga boshllëqet kryesore që e pengon zhvillimin shkencor dhe praktik, nga perspektiva shkencore dhe akademike në fushën e sigurisë publike. Shumë mundësi financimi kombëtare dhe ndërkombëtare mbeten të pashfrytëzuara për shkak të mungesës së organizimit të duhur, përkushtimit akademik dhe profesional, si dhe mbikëqyrjes dhe monitorimit sistematik. Marrë parasysh që arsimi i lartë është krijuar për më shumë se sa një dekadë, produktiviteti shkencor në fushën e sigurisë publike, marrë në konsideratë mundësitë dhe potencialin që ka Akademia, ka qenë tejet i ulët dhe individual.

Marrë në konsideratë ri-organizimin e brendshëm, ri-dizajnimin e roleve dhe përgjegjësi që ka secila njësi dhe rolet individuale, veçanërisht të stafit akademik në Akademi, synimet e Akademisë janë tejet ambicioze dhe inkurajuese. Ky objektivi synon krijimin e mekanizmave të qëndrueshëm për identifikimin e thirrjeve, ngritjen e ekipeve hulumtuese dhe ndërtimin e partneriteteve me institucionet e sigurisë publike dhe partnerë ndërkombëtarë. Përmes punësive dhe aplikimeve të përbashkëta, synohet të rritet jo vetëm numri, por edhe cilësia e projekteve, duke sjellë më shumë burime financiare, teknike dhe shkencore për Akademinë. Realizimi i këtij objektivi do të sigurojë një rol më aktiv të stafit akademik në rrjetet hulumtuese dhe do të forcojë lidhjen midis hulumtimit shkencor dhe praktikave konkrete të sigurisë publike, duke e pozicionuar Akademinë si referencë kredibile shkencore në rang kombëtar dhe me gjerë.

Në kuadër të këtij objektivi strategjik për arritjen e tij janë paraparë këto objektiva specifike:

- 2.1. Monitorimi aktiv i thirrjeve për projekte kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare në fushën e sigurisë publike;
- 2.2. Hartimi dhe dorëzimi i propozimeve për projekte hulumtuese në bashkëpunim me institucionet partnere.

VI.3. OBJEKTIVI 3: Zhvillimi i platformave shkencore për prezantim dhe publikim në fushën e sigurisë publike dhe forcimi i kapaciteteve institucionale për menaxhimin e hulumtimeve

Në fushën e sigurisë publike mungojnë deri tani platforma të qëndrueshme për prezantimin dhe publikimin shkencor, gjë që kufizon shpërndarjen e ideve dhe promovimin e rezultateve të hulumtimit shkencor, por edhe penalizon vet Akademinë si institucion i vetëm në fushën e sigurisë publike. Ky objektiv synon krijimin e hapësirave për prezantim shkencor, përmes organizimit të konferencave dhe tryezave shkencore, por edhe të punëtorive me tema të rëndësishme për sigurinë publike, ku studiuesit, profesionistët e sigurisë, studentët, por edhe partnerët ndërkombëtarë, ndajnë përvojat e tyre, si dhe zhvillojnë ide konkrete për bashkëpunim të ndërsjellë.

Themelimi i revistës shkencore në studime të sigurisë publike përfaqëson një hap të rëndësishëm në drejtim të ngritjes së Akademisë në një institucion të rëndësishëm shkencor në fushën e sigurisë publike, duke rritur në këtë mënyrë edhe interesin konkret, por edhe rritjen e reputacionit vendor dhe ndërkombëtar. Krijimi dhe sigurimi i qëndrueshmërisë së revistës shkencore, përmes publikimeve në numra të caktuar, si dhe përgatitjes për indeksim ndërkombëtar në data-baza shkencore, do të sigurohet një platformë shkencore e respektuar për publikimin e punimeve shkencore origjinale dhe të aplikueshme në praktikë. Në aspektin shkencor, synimi kryesor i Akademisë është të shndërrohet në një qendër referuese për krijimin, zhvillimin dhe shpërndarjen e produkteve shkencore në fushën e sigurisë publike, duke krijuar ndikim të rëndësishëm dhe të matshëm në shkencë dhe shoqëri.

Gjithashtu ky objektiv synon krijimin e një strukture funksionale të qartë për menaxhimin e komponentës së hulumtimeve, duke siguruar që proceset të jenë të planifikuara, të monitoruara dhe të vlerësuara në mënyrë transparente. Akademia synon të garantojë qartësi në ndarjen e përgjegjësisë, koordinim më të mirë ndërmjet njësive, si dhe rritje të besueshmërisë së rezultateve të hulumtimeve në raport me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare.

Në kuadër të këtij objektivi strategjik për arritjen e tij janë paraparë këto objektiva specifike:

- 3.1. Organizimi i konferencës, tryezave dhe punëtorive shkencore periodike;
- 3.2. Themelimi dhe zhvillimi i revistës shkencore në studime të sigurisë publike;
- 3.3. Forcimi i kapaciteteve institucionale për menaxhimin e hulumtimeve.

VII. ZBATIMI, MONITORIMI DHE VLERËSIMI

Instituti për Hulumtim dhe Zhvillim është përgjegjës për zbatimin e Planit strategjik për hulumtimet shkencore në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike 2026-2028, në koordinim me njësitë përgjegjëse të AKSP-së dhe stafin akademik.

Detyrë e IHZH është gjithashtu planifikimi i kërkesave buxhetore për arritjen e objektivave të planit të hulumtimit sipas afateve të caktuara, duke siguruar që burimet financiare të jenë të harmonizuara me nevojat e aktiviteteve hulumtuese.

Udhëheqësi i IHZH raporton çdo tre muaj tek Dekani lidhur me ecurinë e zbatimit të planit dhe ofron të dhënat e nevojshme për Departamentin për Planifikim Strategjik dhe Çështje Ligjore, të cilat shërbejnë për pasqyrimin e progresit, matjen e rezultateve dhe përgatitjen e raporteve për strukturat udhëheqëse të Akademisë. Në fillim të çdo viti akademik, udhëheqësi i IHZH përgatit dhe paraqet raportin vjetor të performancës së IHZH tek Këshilli i Fakultetit.

Lidhur me zbatimin e fushave prioritare të hulumtimit në siguri publike, obligohet IHZH t'i bëjë propozim dekanit i cili shqyrton, vlerëson dhe vendos, dhe më pas i dërgon Këshillit të Fakultetit për miratim. Lidhur me zbatimin e planit, Dekani mund të merr veprime konkrete dhe të angazhohet brenda fushëveprimit që mbulon Fakulteti lidhur me zbatimin e planit nga stafi akademik.

Dekani ushtron mbikëqyrjen e përgjithshme të zbatimit të planit strategjik dhe planit të tij të veprimit, duke siguruar harmonizimin e aktiviteteve ndërmjet njësive përkatëse dhe lidhjen e tyre me objektivat strategjike. DPSÇL luan rol mbështetës në monitorimin dhe vlerësimin institucional, duke përdorur të dhënat e raportuara nga IHZH për të garantuar transparencë, përgjegjshmëri dhe përshtatshmëri të planit strategjik me zhvillimet akademike dhe hulumtuese.

VIII. PLANI I VEPRIMIT I PLANIT STRATEGJIK TË HULUMTIMEVE SHKENCORE NË AKADEMINË E KOSOVËS PËR SIGURI PUBLIKE 2026-2028

OBJEKTIVI 1: RRIJTJA E PRODUKTIVITETIT SHKENCOR NË FUSHËN E SIGURISË PUBLIKE					
1.1. Publikimi i punimeve shkencore dhe mbështetja financiare për publikime me cilësi dhe ndikim të lartë					
Aktivitetet	Afati Kohor	Njësitë përgjegjëse (mbështetëse)	Kosto financiare	Burimi i Financimit	Treguesi i matjes
1.1.1. Publikimi i punimeve shkencore në fushën e sigurisë publike në revista shkencore (SCOPUS & WoS)	2026 - 2028	Secili mësimdhënës	Deri 1,000 € për mësimdhënës	Buxheti i AKSP	Së paku një punim në vit si autor i parë i publikuar për mësimdhënës
1.1.2. Monitorimi dhe raportimi vjetor i publikimeve të mbështetura	2026 - 2028	IHZH	Kosto administrative	Buxheti i AKSP	Raportet vjetore
1.2. Pjesëmarrja në projekte kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare					
Aktivitetet	Afati Kohor	Njësitë përgjegjëse (mbështetëse)	Kosto financiare	Burimi i Financimit	Treguesi i matjes
1.2.1. Identifikimi i thirrjeve për projekte në fushën e sigurisë publike (në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar)	2026 - 2028	IHZH & DMJ	Kosto administrative	Buxheti i AKSP	Numri i thirrjeve të shpërndara stafit
1.2.2. Formimi i ekipeve hulumtuese për aplikim në projekte	2026 -2028	IHZH & Dekani	Kosto administrative	Buxheti i AKSP	Krijimi i ekipeve
1.2.3. Aplikimi me projekte të përbashkëta me institucionet e sigurisë dhe partnerët ndërkombëtarë	2026 -2028	IHZH & Dekani	Kosto minimale	Buxheti i AKSP/ partnerë ndërkombëtarë	Numri i aplikimeve të dorëzuara
1.2.4. Monitorimi dhe raportimi i projekteve të fituara	2026-2028	IHZH	Kosto administrative	Buxheti i AKSP/ partnerë ndërkombëtarë	Numri i projekteve të fituara; raportet e zbatimit
1.3. Mobiliteti akademik dhe pjesëmarrja në konferenca, seminare e punëtori					
Aktivitetet	Afati Kohor	Njësitë përgjegjëse (mbështetëse)	Kosto financiare	Burimi i Financimit	Treguesi i matjes
1.3.1. Pjesëmarrja e stafit akademik në konferenca shkencore me tema në fushën e sigurisë publike	2026-2028	Dekani & IHZH	5,000 € në vit	Buxheti i AKSP / Partnerë ndërkombëtarë	Së paku 1 konferencë vendore/rajonale/ndërkombëtare për mësimdhënës;

1.3.2. Pjesëmarrja e stafit akademik në programe mobiliteti (Erasmus+, IPA, projekte rajonale)	2026-2028	Dekani, IHZH & DMJ	Kosto e mbuluar kryesisht nga programet	Programet ndërkombëtare të mobilitetit	Sipas thirrjeve vjetore të programeve Numri i shkëmbimeve të realizuara; numri i stafit të përfshirë
1.3.3. Organizimi i sesioneve shkencore - analitike me pjesëmarrje të ekspertëve vendorë dhe ndërkombëtarë (ligjërues, studiues, profesionistë nga fusha e sigurisë publike) për leksione, punëtori dhe shkëmbim përvojash	2026-2028	IHZH, Dekani & DMJ	2,000 - 4,000 € në vit	Buxheti i AKSP / Partnerë ndërkombëtare	Së paku 1 herë në vit Sesionet e mbajtura
1.4. Krijimi i një mjedisi stimulus hulumtues përmes mentorimit, trajnimeve dhe qasjes në burime shkencore bashkëkohore					
Aktivitetet	Afati Kohor	Njësitë përgjegjëse (mbështetëse)	Kosto financiare	Burimi i Financimit	Treguesi i matjes
1.4.1. Zhvillimi i programeve të mentorimit për studiuesit e rinj	2026 -2028	IHZH	Kosto minimale	Buxheti i AKSP	Programi i hartuar Mentorimet e realizuara
1.4.2. Organizimi i trajnimeve metodologjike dhe shkencore për stafin akademik	Së paku 2 herë në vit	IHZH / FSP, DBNJ	3,000 € në vit	Buxheti i AKSP / Partnerë ndërkombëtare	Trajnimet e realizuara
1.4.3. Sigurimi i qasjes në databaza shkencore dhe platforma digjitale hulumtuese (Scopus, WoS, JSTOR, etj.)	2026 - 2028	IHZH / DP, DBF	10,000 € në vit	Buxheti i AKSP / Partnerë ndërkombëtare	Numri i databazave aktive; numri i përdoruesve aktivë nga stafi
1.4.4. Krijimi i një qendre të vogël të burimeve hulumtuese (research hub) brenda Akademisë	2027	FSP / DP, DMJ	10, 000 € (njëherë)	Buxheti i AKSP / Partnerë ndërkombëtare	Funksionalizimi i qendrës
1.5. Botimi i librave universitarë, monografive dhe manualeve praktike					
Aktivitetet	Afati Kohor	Njësitë përgjegjëse (mbështetëse)	Kosto financiare	Burimi i Financimit	Treguesi i matjes
1.5.1. Hartimi dhe publikimi i librave universitarë dhe monografive me interes të fushës së sigurisë publike nga mësimdhënësit me marrëdhënie të rregullt pune	2026-2028	FSP	Deri 2,000 € për botim	Buxheti i AKSP / Partnerë ndërkombëtarë	Së paku 1 libër/monografi e publikuar dhe e përdorshme në mësimdhënie
1.5.2. Hartimi dhe publikimi i manualeve apo udhëzuesve profesionalë për nevojat e institucioneve të sigurisë publike	2026-2028	IHZH & FSP	Deri 1,000 € për botim	Buxheti i AKSP / Partnerët ndërkombëtare	Së paku 1 manual/udhëzues i publikuar dhe i shpërndarë
OBJEKTIVI 2.: RRITJA E NUMRIT TË PROJEKTEVE HULUMTUESE NË FUSHËN E SIGURISË PUBLIKE					
2.1. Monitorimi aktiv i thirrjeve për projekte kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare në fushën e sigurisë publike.					
Aktivitetet	Afati Kohor	Njësitë	Kosto financiare	Burimi i	Treguesi i matjes

		përgjegjëse (mbështetëse)		Financimit	
2.1.1. Monitorimi i rregullt i thirrjeve për projekte (kalendar vjetor i thirrjeve)	Çdo vit	IHZH & DMJ	Kosto administrative	Buxheti i AKSP	Kalendari i thirrjeve i publikuar dhe i përditësuar
2.1.2. Organizimi i sesioneve informuese për stafin akademik mbi thirrjet e hapura dhe kriteret e aplikimit	Së paku 2 herë në vit	IHZH	Kosto administrative	Buxheti i AKSP	Numri i sesioneve të mbajtura; numri i stafit të informuar/pjesëmarrës
2.2. Hartimi dhe dorëzimi i propozimeve për projekte hulumtuese në bashkëpunim me institucionet partnere					
Aktivitetet	Afati Kohor	Njësitë përgjegjëse (mbështetëse)	Kosto financiare	Burimi i Financimit	Treguesi i matjes
2.2.1. Formimi i grupeve punuese të përbashkëta me institucionet e sigurisë për hartimin e projekteve	1 herë në vit	IHZH / Dekani, DP, ISP	Kosto administrative	Buxheti i AKSP	Grupet punuese të formuara
2.2.2. Organizimi i punësive të përbashkëta për zhvillimin e ideve të projektit dhe përgatitjen e draft - propozimeve	Së paku 2 herë në vit	IHZH/ Dekani, DP, DMJ	1,000 € në vit	Buxheti i AKSP / Partnerët ndërkombëtar	Numri i punësive të realizuara; Numri i draft - propozimeve të përgatitura
2.2.3. Dorëzimi i aplikimeve për projekte në thirrjet kombëtare apo ndërkombëtare	Çdo vit sipas kalendarit të thirrjeve	IHZH, FSP / DMJ	Kosto administrative	Buxheti i AKSP / / Partnerët ndërkombëtar	Numri i aplikimeve të dorëzuara; Përqindja e aplikimeve të suksesshme
OBJEKTIVI 3: ZHVILLIMI I PLATFORMAVE SHKENCORE PËR PREZANTIM DHE PUBLIKIM NË FUSHËN E SIGURISË PUBLIKE DHE FORCIMI I KAPACITETEVE INSTITUCIONALE PËR MENAXHIMIN E HULUMTIMEVE					
3.1. Organizimi i konferencës, tryezave dhe punësive shkencore periodike					
Aktivitetet	Afati Kohor	Njësitë përgjegjëse (mbështetëse)	Kosto financiare	Burimi i Financimit	Treguesi i matjes
3.1.1. Organizimi i konferencës shkencore vjetore në siguri publike	1 herë në vit	FSP, IHZH & DMJ	10,000 €/vit	Buxheti i AKSP + partnerë ndërkombëtarë	Libri i abstrakteve të botuar; (ISBN/ISSN); Raporti i finalizuar Botimi i përmbledhjes së punimeve të përzgjedhura me ISBN (proceedings)
3.1.2. Organizimi i tryezave shkencore mbi temat aktuale të sigurisë publike	2 herë në vit	IHZH & FSP	3,000 €/vit	Buxheti i AKSP / partnerë ndërkombëtarë	Tryezat e realizuara; Raporti i finalizuar
3.1.3. Organizimi i punësive tematike me aktorë të sigurisë publike, partnerë ndërkombëtarë, studentë dhe staf akademik	1 herë në semestër	FSP, IHZH & DMJ	3,000 €/vit	Buxheti i AKSP / partnerë ndërkombëtarë	Përmbledhje me rekomandime praktike, ide hulumtuese dhe plane për projekte të përbashkëta

3.2. Themelimi dhe zhvillimi i revistës shkencore në studime të sigurisë publike					
Aktivitetet	Afati Kohor	Njësitë përgjegjëse (mbështetëse)	Kosto financiare	Burimi i Financimit	Treguesi i matjes
3.2.1. Themelimi i revistës shkencore në studime të sigurisë publike	2026	FSP, IHZH / DP	5,000 €	Buxheti i AKSP / Partnerët ndërkombëtar	Revista e themeluar dhe e regjistruar; Bordi editorial i krijuar; Recensuesit e përzgjedhur; ISSN e siguruar; Platforma online funksionale
3.2.2. Publikimi i punimeve, administrimi dhe mirëmbajtja e revistës shkencore	2027, 2028	FSP & IHZH	3,000 €	Buxheti i AKSP / Partnerët ndërkombëtar	Platforma e revistës e mirëmbajtur; Tarifat vjetore të paguara; Procesi editorial i koordinuar; Numrat e publikuar sipas afateve
3.2.3. Përgatitja për indeksim ndërkombëtar (përfshirë DOAJ, SCOPUS në afatmesëm/afatgjatë)	2028	IHZH	Kosto minimale (administrative)	Buxheti i AKSP / Partnerët ndërkombëtar	Dëshmia e aplikimit për indeksim
3.3. Forcimi i kapaciteteve institucionale për menaxhimin e hulumtimeve					
Aktivitetet	Afati Kohor	Njësitë përgjegjëse (mbështetëse)	Kosto financiare	Burimi i Financimit	Treguesi i matjes
3.3.1. Planifikimi dhe dorëzimi i kërkesave buxhetore për hulumtime dhe miratimi i buxhetit adekuat	Para çdo viti buxhetor	IHZH, Dekani, KF, DBF	Kosto administrative	Buxheti i AKSP	Buxheti i aprovuar për hulumtime
3.3.2. Caktimi i bartësve për fushat prioritare të hulumtimit dhe zbatimi i aktiviteteve hulumtuese	Fillim të çdo viti	Dekani, IHZH & KF	Kosto administrative	Buxheti i AKSP	Vendimi i miratuar; Raportet periodike të bartësve për secilën fushë
3.3.3. Monitorimi dhe raportimi periodik i zbatimit të Planit Strategjik për hulumtime	Çdo 6 muaj	IHZH & Dekani	Kosto administrative	Buxheti i AKSP	Raportet e përgatitura
3.3.4. Integrimi i rezultateve hulumtuese në kurrikulën e programit	Para çdo viti akademik	Stafi akademik	Kosto administrative	Buxheti i AKSP	Raport individual dhe të përgjithshëm
3.3.6. Publikimi i raporteve të performancës hulumtuese individuale dhe institucionale	Në fund të secilit vit	IHZH	Kosto administrative	Buxheti i AKSP	Raporti vjetor i publikuar dhe shpërndarë